



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkivo - Arhiva - Archive

Ministria e Financave / Ministry of Finance
06/400
Pr. Prot. / Prot. No. 95.9/2022
Pr. Datum / Date 16.06.2022
PRISHTINEJA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Departament

| | |
|------------------------|--|
| DATE | 14.06.2022 |
| REFERENCË | NV-100/2022 |
| PËR/ZA/TO: | Z. Nuhi Mani, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| CC | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| NGA/OD/FROM: | Remzi Sylejmani, Zv. Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim |

I nderuari z. Mani,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Departamenti i Buxhetit paraqet:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

**OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E
NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme, dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky projektligj ka kosto totale prej 50,600,000€ për vitin 2022.

Departamenti i Buxhetit konstaton se nuk ka ndryshim në mes të koston së vlerësuar nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe koston së verifikuar nga ana e Departamentit të Buxhetit.


Me Ligjin Nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, shuma prej 50,600,000€ e parapare me këtë projektligj është pjese e tabelës 1.1. Financimi i bilancit buxhetor - Financim Direkt Buxhetor - FMN, BB, BE, etj.

Përfundim:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, nga aspekti i ndikimit buxhetor konstaton se shuma prej 50,600,000€ e parapare për këtë projektligj për vitin 2022 është pjese e tabelës 1.1. Financimi i bilancit buxhetor - Financim Direkt Buxhetor-FMN, BB, BE, etj., të Ligjit me Nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Përgatitur nga:

Antigona Bekaj, Analiste e lartë e buxhetit



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror

